



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



### Terma Reference

<b>Pozicioni:</b>	<b>Ekspert i jashtëm psikolog për ofrimin e shërbimit psikologjik</b>
<b>Projekti:</b>	<b>Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe qasjes riintegruese nga agjensitë ligjzbatuese për gratë e privuara në proces lirimi dhe tek të miturit recidivist</b>
<b>Bashkia:</b>	<b>Tiranë</b>
<b>Lloji i kontratës:</b>	<b>Kontratë Shërbimi</b>

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të punësojë një ekspert të jashtëm psikolog për ofrimin e shërbimit psikologjik për rastet e të miturve në konflikt me ligjin të referuar nga Shërbimi i Provës, pjesë e programit “Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe qasjes riintegruese nga agjensitë ligjzbatuese për gratë e privuara në proces lirimi dhe tek të miturit recidivist”. zbatuar nga organizata TLAS dhe financuar nga Bashkimi Evropian.

### **Informacion i Përgjithshëm**

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Mision i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Eksperti do të realizojë vlerësimin psikologjik të të miturve të referuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Provës në Bashkinë Tiranë.

Eksperti me mbështetjen e organizatës pritet:

- të realizojë vlerësimin psikologjik të të miturve të referuar nga Shërbimi i Provës ;
- të realizojë mbështetjen me seanca këshillimi/terapi të vazhdueshme psikologjike të të miturve sipas një plani individual zhvillimi në koordinim të plotë me menaxherin e rasteve të Shërbimit të Provës;



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



- të identifikojë problematikat/vështirësitë në fushat e zhvillimit dhe do të mundësojë rekomandime për trajtim të mëtejshëm psikologjik (në rastet kur është e nevojshme);
- të njohë dhe zbatojë teknikat profesionale/metodat psikologjike në krijimin e marrëdhënieve dhe trajtimin në vazhdimësi të rastit, bazuar në besim dhe respekt në përputhje me etikën profesionale;
- të realizojë një plan individual ndërhyrje për secilin të mitur të vlerësuar;
- të vlerësojë përputhshmërinë në aspektin funksional, emocional dhe psikologjik të fëmijës me gjendjen e tij aktuale dhe mundësisë për riintegrim;
- të përgatisë një raport përmbledhës mbi procesin e vlerësimit të fëmijës si dhe të përfshijë në të rekomandime për institucionin e Shërbimit të Provës;
- Të njohë dhe zbatojë me profesionalizëm dokumentacionin e punës së organizatës (rregulloren e brendshme, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodin e sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë djeni).

## Profili i Punonjësit

### I. Kualifikime

- Diplomë universitare në psikologji, ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e psikologjisë;
- Njohuri shumë të mira rreth procesit të vlerësimit psikologjik dhe përshtatjes së terapisë në varësi të zhvillimit të fëmijës;
- Njohuri shumë të mira të teknikave të ndërthurura psikologjike në ofrimin e shërbimit psikologjik.

### II. Eksperienca e punës

- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert në fushën e shërbimeve psikologjike me të miturit në kontakt me ligjin;
- Trajnime dhe eksperiencë të mëparshme në vlerësimin psikologjik të fëmijëve;
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Aftësi në monitorimin, vlerësimin dhe analizën për rastet e ndjekura;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe dhe në mënyrë të pavarur.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



### 1. Procedura e Aplikimit

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit psikolog duhet të dërgojnë me email CV-në e tyre dhe një letër interesi për Nisma në adresën e emailit: [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com) deri në datën **08.10.2020**, mesnatë.

### 2. Procedura e Vlerësimit

Zgjedhja e personit do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	20%
Eksperiencë pune	50%
Intervista	30%

*Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët për pozicionin e ekspertit do të kontaktohen.*